

VENDIM
Nr. 33, datë 21.1.2026

PËR PËRCAKTIMIN E FUSHAVE TË RËNDËSISË SË VEÇANTË TË KËRKIMIT SHKENCOR, PËR TË CILAT KËRKOHEJ LEJE E VEPRIMTARISË KËRKIMORE-SHKENCORE, SI DHE TË KRITEREVE E TË PROCEDURAVE PËR LËSHIMIN E LEJES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 19, të ligjit nr. 109/2024, “Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. FUSHAT E RËNDËSISË SË VEÇANTË TË KËRKIMIT SHKENCOR, PËR TË CILAT KËRKOHEJ LEJE E VEPRIMTARISË KËRKIMORE-SHKENCORE

Përcaktimin e fushave të kërkimit shkencor të një rëndësie të veçantë, për të cilat kërkohet leje e veprimtarisë kërkimore-shkencore, të cilat janë në përputhje me ligjin nr. 109/2024, të detajuara, si më poshtë vijon:

a) Biosiguria – Kërkime shkencore të kërcënimeve biologjike, të tilla si sëmundjet infektive, bioterrorizmi etj.;

b) Siguria bërthamore – Kërkime shkencore të fokusuara në përhapjen bërthamore, kontrollin e armëve, parandalimin e terrorizmit bërthamor dhe shfrytëzimin e energjisë bërthamore për pavarësi energjetike;

c) Shëndetësia – Kërkime shkencore, që përfshijnë përdorimin, prodhimin, manipulimin ose magazinimin e agjentëve biologjikë me risk të lartë (BSL-3 dhe BSL-4), kërkime me karakter “*dual-use*” apo aktivitete që paraqesin rrezik të drejtpërdrejtë për sigurinë kombëtare, me përjashtim të kërkimeve rutinë në shëndetin publik, përfshirë survejancën epidemiologjike, analizat statistikore, studimet retrospektive, monitorimin e ujit, ushqimit, ajrit, tokës, biodiversitetit, entomologjinë, rodentologjinë, si dhe aktivitetet e Programit Kombëtar të Imunizimit dhe Kontrollit të Infeksioneve, të cilat nuk i nënshtrohen detyrimit për leje sipas këtij vendimi;

ç) Kimikatet – Vetëm kërkimet shkencore, që përdorin ose prodhojnë substanca kimike me risk të lartë, CMR 1A/1B, “*Highly Hazardous Chemicals*”, sipas listave ndërkombëtare dhe Konventës për Armët Kimike.

II. KRITERET PËR DHËNIEN E LEJES PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NË NJË FUSHË TË NJË RËNDËSIE TË VEÇANTË

Institutet e kërkimit shkencor dhe njësitë e veçanta të kërkimit shkencor, që krijohen për të ushtruar veprimtarinë e tyre në fusha të një rëndësie të veçantë, apo që kërkojnë të shtojnë në aktivitetin e tyre veprimtarinë në fushat e një rëndësie të veçantë të kërkimit shkencor, plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a) të jenë krijuar e regjistruar në Republikën e Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi;

b) të jenë të regjistruara në Regjistrin Kombëtar të Institucioneve, Instituteve, Njësive të Veçanta të Kërkimit Shkencor dhe Kërkuesve Shkencorë;

c) të zotërojnë burime njerëzore të kualifikuara me përvojë shkencore në fushën përkatëse;

ç) të paraqesin planin kërkimor-shkencor të detajuar e të argumentuar për qëllimet, metodat dhe rezultatet e pritshme të projektit;

d) të kenë mekanizma të brendshëm për vlerësimin e shmangies së riskut në kërkimin shkencor;

dh) të disponojnë infrastrukturë kërkimore-shkencore të nevojshme, në përputhje me fushën e rëndësisë së veçantë, që t'i shërbejnë funksionimit normal të veprimtarisë kërkimore-shkencore;

e) të disponojnë burimet e financimit dhe të garantojnë qëndrueshmërinë financiare.

III. PROCEDURAT PËR DHËNIEN E LEJES PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NË NJË FUSHË TË NJË RËNDËSIE TË VEÇANTË

1. Institutet e kërkimit shkencor dhe njësitë e veçanta të kërkimit shkencor paraqesin kërkesë, nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania”, për përfitimin e lejes për ushtrimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore në një fushë të rëndësisë së veçantë, pranë ministrisë përkatëse, sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore, në të cilën do të ushtrohet veprimtaria e fushës së rëndësisë së veçantë.

2. Institutet e kërkimit shkencor dhe njësitë e veçanta të kërkimit shkencor paraqesin dokumentacionin justifikues të përmbushjes së kriterëve, si më poshtë vijon:

a) aktin e krijimit si person juridik publik apo privat në formën e institutit apo të njësisë së veçantë të kërkimit shkencor;

b) vërtetimin e regjistrimit në Regjistrin Kombëtar të Institucioneve, instituteve, njërive të veçanta të kërkimit shkencor dhe kërkuesve shkencorë;

c) dokumentacionin justifikues, që zotërojnë burime njerëzore të kualifikuara me përvojë shkencore në fushën përkatëse;

ç) planin kërkimor-shkencor të detajuar, përfshirë afatin e zbatimit dhe argumentimin lidhur me qëllimet, metodat e rezultatet e pritshme të projektit;

d) vlerësimin e Komitetit të Etikës për shmangien e riskut në kërkimin shkencor, në përputhje me Kodin e Etikës në Shkencë dhe në Kërkim Shkencor për projektin kërkimor dhe ndryshimin e tij për veprimtaritë e produktin e kërkimit shkencor;

dh) dokumentacionin justifikues, që disponon infrastrukturë kërkimore-shkencore të nevojshme, në përputhje me fushën e rëndësisë së veçantë, që t'i shërbejnë funksionimit normal të veprimtarisë kërkimore-shkencore;

e) dokumentacionin justifikues që disponon burimet e financimit dhe garanton qëndrueshmëri financiare.

3. Ministria përkatëse, sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore, shqyrton aplikimin brenda 20 (njëzet) ditëve, sipas procedurave të brendshme. Në rast se konstaton që kërkesa është paraqitur me dokumentacion të plotë, përcillet pranë ministrisë përgjegjëse për çështjet e shkencës dhe të kërkimit shkencor, shoqëruar me vlerësimin e saj mbi aplikimin. Në rast të mungesës së dokumentacionit, ia përcjell subjektit kërkues për të bërë plotësime brenda 10 (dhjetë) ditëve. Në rast të plotësimit të dokumentacionit, vijohet me shqyrtimin e kërkesës, në të kundërt kërkesa konsiderohet e arkivuar.

4. Ministria përgjegjëse për çështjet e shkencës dhe të kërkimit shkencor shqyrton propozimin brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, bazuar mbi vlerësimin e ministrisë përkatëse, sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore.

5. Propozimi për dhënie ose refuzimin e lejes për ushtrimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore në një fushë të një rëndësie të veçantë i paraqitet ministrit për çështjet e shkencës dhe të kërkimit shkencor për vendimmarrje.

Ministri miraton, me urdhër, dhënie e lejes, duke përfshirë edhe kohëzgjatjen e saj, sipas afatit në planin kërkimor-shkencor.

6. Subjekti, të cilit i është refuzuar dhënia lejes, ka të drejtën e ankimit pranë ministrisë përgjegjëse për çështjet e shkencës dhe të kërkimit shkencor, në përputhje me përcaktimet e Kodit të Procedurave Administrative.

7. Leja e dhënë regjistrohet në Regjistrin Kombëtar të Institucioneve, Instituteve, Njësive të Veçanta të Kërkimit Shkencor dhe Kërkuesve Shkencorë.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Për fusha të tjera të kërkimit shkencor, që nuk janë të parashikuara në këtë vendim, veprimtaria kërkimore-shkencore ushtrohet nga institutet dhe njësitë e veçanta të kërkimit shkencor, në përputhje me legjislacionin në fuqi për shkencën e kërkimin shkencor dhe legjislacionin specifik të fushës, për pajisjen me leje për ushtrimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore në atë fushë.

2. Procedura e aplikimit, sipas këtij vendimi, nëpërmjet portalit unik qeveritar “*e-Albania*”, zbatohet pasi ministria përgjegjëse për çështjet e shkencës e të kërkimit shkencor të publikojë në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare përfundimin e zhvillimeve teknike për realizimin e procedurës në Sistemin Shqiptar të Informacionit të Kërkimit Shkencor (ACRIS).

3. Kërkesa për përfitimin e lejes për ushtrimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore në një fushë të rëndësishë së veçantë, së bashku me dokumentacionin, paraqiten në formë të shkruar pranë ministrisë përkatëse, sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore, në të cilën do të ushtrohet veprimtaria e fushës së rëndësishë së veçantë, deri në momentin e implementimit e të funksionalitetit të Sistemit Shqiptar të Informacionit të Kërkimit Shkencor (ACRIS).

4. Ngarkohen ministria përgjegjëse për çështjet e shkencës dhe të kërkimit shkencor, ministritë përkatëse, sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore, institutet dhe njësitë e veçanta kërkimore-shkencore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama